



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 4 tetor 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni – kryetar, Gani Geci, Bajram Kosumi, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Kolë Berisha, Adem Hajdaraj, Mufera Şinik dhe Radmila Vujoviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Petrit Hysaj – OSBE, Isuf Zejna – KDI, Juxhina Brosch – PAK, Teuta Rexhepi – Bota sot, Valentina Rafuna – TV Rrokum.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.09. 2010;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për rregullatorin e energjisë;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.9. 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.9. 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për rregullatorin e energjisë

Kryetari, i paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet në Projektligjin për rregullatorin e energjisë, të propozuara nga Komisioni Funksional. Kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji për rregullatorin e energjisë dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
4. **Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë**

Kryetari paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet në Projektligjin për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, të propozuara nga Komisioni Funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për energjinë elektrike.

Komisioni kishte vërejtje në amendamentin 35 ku diskutuan: Bahri Hyseni, Ibrahim Makolli, Gani Geci dhe Armend Zemaj.

Meqë kishte vërejtje kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji për energjinë elektrike dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përveç amendamentit 35.
2. Komisioni sugjeron që në amendamentin 35, neni 39, paragrafi 1.7, në rreshtin e katërt fjalët **“me nenet 316 – 318 të Kodit të Përkohshëm”** të hiqen dhe të zëvendësohen me fjalët **“me dispozitat e Kodit”**.
3. Në paragrafin 5 të këtij neni, në rreshtin e tretë, fjalët **“e aplikueshme të Kreut V të Kodit të Përkohshëm”** hiqen dhe zëvendësohen me fjalët **“e Kodit”**.
4. Në paragrafin 7.1, në rreshtin e katërt, fjalët **“deri në 3 vjet sipas vendimit të gjykatës”** hiqen dhe zëvendësohen me fjalët **“sipas dispozitave të Kodit penal të Kosovës.”**

b. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës

Kryetari i paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet në Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe kërkoi që të ato të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji për mbrojtjen e konkurrencës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni